



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.50, PARAQITUR NË KQZ NË
DATËN 05.07.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 06.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: **Partia Bindja Demokratike**

OBJEKT: Për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Librazhd.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa (c) dhe pika 4, si dhe neni 126, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Partia Bindja Demokratike ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, me objekt "kundërshtimin e rezultatit të votimit për zgjedhjen për këshillin e Bashkisë Librazhd" e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me Nr.50 regj, datë 05.07.2019.

Rezulton se KZAZ nr.52 me vendimin nr.201, datë 02.07.2019 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e këshillit të Bashkisë Librazhd" ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve për këshillin e bashkisë Librazhd .

KQZ, referuar nenit 129 të Kodit Zgjedhor bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore, në lidhje me elementet e formës të përcaktuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor si dhe verifikon elementet e mëposhtme të përcaktuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor:

- a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;
- b) legjitimitimin e ankuesit; dhe
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin.



Në datë 06.07.2019 ora 11.00, pas relativitetit të Z.Denar Biba u konstatua se kërkesa ankimore plotëson elementet e përcaktuara nga neni 130 i Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 124 të Kodit Zgjedhor, partitë politike, kanë të drejtë të ankimohen në KQZ, kundër vendimeve të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

KQZ, referuar objektit të ankimit, datës së vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për këshillin e bashkisë Librazhd, dhe faktit se Partia Bindja Demokratike është subjekt zgjedhor, konstaton se është kompetente për shqyrtimin e ankimit, ankuesi legjitimohet si dhe ankimi respekton afatet ligjore.

Nga verifikimi i elementeve të formës të përcaktuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, rezulton se kjo kërkesë ankimore nuk plotëson elementët e formës duke mos plotësuar kërkesat e nenit 126, pika 1 gema b, c, ç, d dhe dh të Kodit Zgjedhor. Konkretisht, kërkesa nuk është plotësuar sipas formatit të përcaktuar nga KQZ, mungon referimi tek vendimi që ankimohet, mungon baza ligjore, është i paqartë përshkrimi i shkurtër i shkëljes së pretenduar, është i paqartë përshkrimi i fakteve argumenteve dispozitive ligjore, mungon tregimi i provave të cilat kërkon të marrë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, si dhe burimin e tyre.

Gjithashtu referuar nenit 126, pika 2 kërkesës ankimore nuk i është bashkëlidhur kopja e vendimit të KQZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve, ndaj të cilit subjekti zgjedhor ankues ka ushtruar ankim në KQZ.

Për sa më sipër në bazë të nenit 129, pika 3, germa "c" të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja pasi bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore dhe në rast të mungesës së një prej elementëve të formës, të parashikuara nga neni 126 i Kodit Zgjedhor vendos kthimin për plotësim të saj.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa "c" dhe pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

- 1- Kthimin për plotësim të kërkesës ankimore nr.50, datë 05.07.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 3- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

